



Njoftim për shtyp 24 Tetor 2019

24 October, 2019 by **KLGJ** in **NJOFTIME PËR SHTYP**

Sot më datë 24.10.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor zhvilloi mbledhjen plenare të radhës në të cilën miratoi verifikimin e kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin si gjyqtar, të 12 (dymbëdhjetë) kandidatëve diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës, për profilin gjyqtar, në përfundim të vitit akademik 2018-2019.

Procedura e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore u bë në përputhje me vendimin Nr. 75, datë 23.05.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për rekrutimin si gjyqtar të kandidatëve, si më poshtë:

Znj. Erlanda Agaj, z. Marko Boshku, znj. Elisabeta Gjoni, znj. Klejda Çapja, z. Artur Prenga, z. Mirjan Mustafaj, znj. Kostandina Kuro, znj. Iva Zemani, znj. Enisa Shahini, znj. Ema Shaholli, z. Shkëlzen Licaj dhe z. Xhevdet Lika.

Vendim i sotëm i KLGJ-së merr një rëndësi të veçantë, nëse mbahen parasysh efektet dhe mungesat e krijuara nga procesi i rivlerësimit kalimtar, nevojat e sistemit për kontributin profesional të këtyre magjistratëve të rinj për t'u ofruar qytetarëve shqiptar një drejtësi siç e meritojnë dhe pa vonesa.

Gjithashtu, Këshilli vendosi deklarin e mbarimit të statusit të magjistratit, të kryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Durrës, znj. Joana Qelesi, për shkak të dorëheqjes nga detyra e gjyqtarit.